



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

**THIRRJE PËR BURSA STUDIMI NË REPUBLIKËN ÇEKE, VITI AKADEMIK
2026-2027**

Ambasada e Republikës së Çekisë njofton se Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit të Republikës Çeke ofron për studentët shqiptarë:

- 3 bursa për qëndrime studimore në nivelin bachelor, master dhe doktoratë (me një kohëzgjatje totale prej 18 muajsh, ndërsa kohëzgjatja e qëndrimeve individuale është nga 2 deri në 9 muaj në vit),
- 2 muaj për stafin akademik për qëndrime studimore dhe kërkimore (kohëzgjatja e qëndrimeve individuale nuk e tejkalon 1 muaj).

Kushtet e pranimiit dhe kërkesat në lidhje me gjuhën e shkollimit përcaktohen në mënyrë autonome nga universitetet pritëse, të cilat marrin vendime të pavarura nëse çdo aplikant mund të pranohet ose jo në kuadrin e programit të bursave. Një informacion i detajuar rreth formës së aplikimit dhe dokumentave të tjerë gjendet në faqen web të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit të Republikës Çeke: <https://msmt.gov.cz/eu-and-international-affairs/scholarships-for-the-academic-year-2026-2027>

Një listë e institucioneve publike të arsimit të lartë në Republikën Çeke, së bashku me një pasqyrë të programeve dhe fushave të studimit të ofruara në gjuhën angleze, është e disponueshme në faqen zyrtare <https://www.studyin.cz>.

Informacione të detajuara mbi programet e studimit janë të disponueshme në faqet e internetit të universiteteve përkatëse.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit, nëpërmjet postës, **brenda datës 13 mars 2026**, dokumentacionin përkatës në anglisht sipas listës në vijim:

- Formularin e aplikimit;
- Kopjen e noterizuar të diplomës (nëse diploma është e huaj duhet edhe njehsimi sipas sistemit shqiptar) ose të ndonjë dokumenti të ngjashëm që vërteton mbarimin e programit të studimit;
- Kopjen e noterizuar të listës së notave;
- Vërtetimin nga universiteti përkatës për kandidatët që ndjekin aktualisht studimet universitare;
- Fotokopjen e faqes së pasaportës me të dhënat e identitetit;
- Plani i detajuar i studimit/kërkimit;
- Dy letra rekomandimi nga mbikëqyrësit akademikë ose një punëdhënës;
- CV në anglisht.

DREJTORIA E INTEGRIMIT, MARRËVESHJEVE DHE PROJEKTEVE